



Në bazë të nenit 15, 19 dhe 20 të Ligjit mbi Planifikimin hapësinor, nr. 2003/14 dt. 03.07.2003, te nenit 11 te Ligjit për Ndryshimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor 2003/14, nr. 03/L-1069 ("Gazeta Zyrtare Republikës se Kosovës",nr. 48/2008), të nenit 17 dhe 58 të Ligjit për Qeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008, të nenit 15 al.1 shkronja "b" të Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 01-110-391 të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me 26.5.2011 merr:

V E N D I M

MBI QASJEN E PLOTËSIMIT DHE NDRYSHIMIT TË PLANIT RREGULLUES URBAN TË LAGJES "KALABRIA"

Neni 1

I qaset plotësimin dhe ndryshimit të Planit Rregullues Urban të lagjes "Kalabria", 01 nr-35-18196 të dt. 03.08.2005, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës..

Neni 2

Me ndryshimet dhe plotësimet e Planit Rregullues Urban të lagjes "Kalabria" ,rishqyrtohet në tërësi plani dhe gjendja faktike në terren.

Neni 3

Bartës i përgatitjes për hartimin e plotësimin dhe ndryshimit të Planit Rregullues Urban për lagjen "Kalabria" është Drejtoria për Urbanizëm, Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Prishtinës, që do të nxjerrë programin e përgatitjes së ndryshimeve dhe plotësimeve.

Neni 4

Për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues Urban të lagjes "Kalabria" nga neni 3 i këtij Vendimi, Komuna mund të angazhojë ekspertë nga lëmi i planifikimit hapësinor, si pjesëmarrëse në përgatitjen e ndryshimit dhe plotësimin të këtij plani.

Neni 5

Plani Rregullues Urban i përshkruar në nënin 2 të këtij vendimi, do të miratohet me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria Pronës e Komunës së Prishtinës.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi dhe aplikohet ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Ditën e miratimit të këtij Vendimi, shfuqizohen nuk vlejn më së vlejtori parametrat-destinimet ekzistuese për pjesë të caktuara të sipërfaqeve të përfshira dhe trajtuara brenda kufijve të Planit Rregullues Urban të lagjes “Kalabria”

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SE PRISHTINES

01. Nr. 35-1146 Më 27.5.2011

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti , ecc.i dipl.

A R S Y E T I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN
TË LAGJES "KALABRIA" NË PRISHTINË

Plani Rregullues Urban për lagjen "Kalabria" është miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal me nr. 01-35 - 18196 dt. 03. 08. 2005.

Në bazë të këtij Plani gjatë kësaj periudhe ~6 vjeçare nga ana e Drejtorisë së Urbanizmit, janë lëshuar një numër i konsiderueshëm i lejeve urbanistike, janë aprovuar 21 zgjidhje urbane, janë aprovuar shumë projekte ideore, dhe janë lëshuar 31 leje ndërtimore, në procedurë janë edhe 5 kërkesa për këtë lagje.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë vërejtur mangësit[dhe janë paraqitur problemet lidhur me realizimin e këtij Plani Rregullues në teren.

Ndër problemet kryesore që janë paraqitur gjatë implementimit të këtij Plani Rregullues është:

1. Ndryshimi i trasesë së disa rrugëve,
2. Ndërtimi i kolektorit të lumit "Prishtina",
3. Lëvizja e trasesë së rrugës unazore,
4. Eliminimi i rrugës së planifikuar në drejtim të aeroportit,
5. Sipërfaqet e planifikuara të gjelbrimit në tërësinë urbane F, blloku C3 dhe një pjesë e bllokut C6 të trajtuara si zonë e konservimit të gjelbrimit,
6. Ndryshimi i pozitës së dy rrethrotullimeve nga ana e Ministrisë së Transportit,
7. Llogarria e vështirë për shkak të dy koeficientëve të ndryshëm të paraparë ndaras për banim dhe afarizëm (çka nuk është rasti te asnjë plan tjetër rregullues), etj.

Pasë shqyrtimit të dokumentacionit dhe gjendjes faktike në terren Drejtoria për Urbanizëm Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit e konsideron të domosdoshme që të revidohet Plani Rregullues Urban për lagjen "Kalabria" në tërësi duke marrë parasysh se shmangia nga Plani është mbi përqindjen e lejuar sipas Ligjit të Planifikimit Hapësinor, gjendjes së re në terren dhe kërkesave te qytetarëve.

Ndryshimet dhe plotësimet e Planit Rregullues Urban për lagjen "Kalabria" duhet të përfshijnë pjesën tekstuale dhe atë grafike.

Plani Rregullues Urban i lagjes "Kalabria", ndryshohet dhe plotësohet në pjesët e përshkruara si më poshtë:

- Shqyrtimi i gjendjes faktike,
- Analizat e faktorëve natyrorë , demografikë, ekonomikë, socialë,
- Shqyrtimi i trafikut dhe infrastrukturës,

- Shqyrtimi i gjendjes ekzistuese të objekteve të banimit nëpër blloqe dhe statusi i tyre,
- Rishqyrtimi i koeficientëve dhe parametrave urbanistikë, duke përfshirë edhe distancat,
- Rishqyrtimi i tërësisë urbane F sipas gjendjes faktike në harmoni me Planin Strategjik dhe kërkesat,
- Bartja e projekteve të hartuara dhe projekteve që janë në procesin e implementimit në Planin e reviduar dhe inkorporimi me rrjetin e ri të rrugëve, sikurse:
 - a) Projekti kryesor i hartuar për rrugën dhe kolektorin mbi lumin “Prishtina”, që është në fazën e implementimit, duhet të bartet në Planin (e reviduar) Rregullues Urban “Kalabria”,
 - b) Projekti Kryesor i hartuar për mbulimin e “Prockës së Matit”, që kalon nëpër këtë lagje dhe planifikohet të ndërtohet rruga mbi këtë prockë, duhet të rishiqohet dhe të bartet në Planin (e reviduar) Rregullues Urban të Kalabrisë.
 - c) Me projektin kryesor të rrugës së Unazës së Brendshme të qytetit, është ndryshuar trasea e kësaj rruge, ndryshimi duhet të përcillet në Planin Rregullues dhe të trajtohet sipërfaqja ndërrmjet rrugës unazore dhe blloqeve të këtij Plani (sipas gjendjes egzistuese),
- Infrastruktura sociale dhe destinimet tjera të rivendosura të inkorporohen në planin e reviduar,
- Plani i reviduar duhet të përmbajë Vlerësimin e trashigimisë kulturo-historike,
- Shqyrtimin e vlerësimit të ndikimeve mjedisore,
- Bilancin e sipërfaqeve, kalkulimin e sipërfaqeve publike,
- Prezentimin e formës së implementimit të planit dhe
- detyrimet tjera të përcaktuara sipas detyrës projektuese.